

FORMULAR TIP I

Date: ___/___/2024

NJOFTIM PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDNDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR T'U PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", të ndryshuar, Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" të ndryshuar, Ligjin Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" të ndryshuar dhe VKM 419 nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" të ndryshuar, Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; *Aplikim për leje mjedisi të tipit B*
2. Të dhënat e esktraktit të QKR-së; *Shoqëria "GEGA OIL GROUP" Sh.A,*
NIPT: K76911001E
3. Adresën e vendndodhjes së instalimit; *Autostrada Durres - Tiranë, Vrrine, Durrës*
4. Përshkrim i veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- *Industria energjitike:*
ID 1.9 Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj:
a). Magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një cisternë e lëvizshme, cisternë hekurudhore ose anije e ujërave të brendshme në terminal.
b). Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant"
5. Një përshkrim të elementëve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkomunal, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkomunale, kur kërkohet sipas legjisllacionit në fuqi; *Nuk ka*
8. Autoritetin vendimarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; *Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, afatet janë sipas Kreut III, pika 10 e VKM nr. 419, datë 25.6.2014 e ndryshuar.*
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit;
info@akm.gov.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë



Adrese e-maili

legal@gegaoil.al

Adresa

Autostrada Durres - Tiranë, Vrrine, Durrës